



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim me zgjedhje)

**LËNDA:
TEKNOLOGJI E THELLUAR**

Koordinatorë: Edlira Sina

Viti shkollor: 2013 -2014

**TIRANË
JANAR, 2014**

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën “**Teknologji e thelluar**” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndës së **Teknologjisë bërthamë dhe asaj të Teknologjisë me zgjedhje të detyruar** për gjimnazin. Në mënyrë më specifike, vlera e edukimit teknologjik vjen nga përdorimi i një grupi të gjerë aftësish të nevojshme për projektimin apo prodhimin e një produkti, duke çuar në zhvillimin e kompetencës dhe ndjesisë së mundësive personale për t’i zbatuar këto aftësi. Fitimi i aftësive manipulative (përpunuese) përbën një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e kompetencës dhe i ndihmon nxënësit të kenë ndjesinë e kontrollit ndaj mjedisit të tyre fizik.

Teknologjia **kontribuon** në një edukim të balancuar, duke u dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t’u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e manipulative dhe kompetenca, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës krijues në një botë teknologjike.

Teknologjia u krijon mundësi nxënësve të integrojnë njohuritë dhe shkathtësitë/shprehitë, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendim reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve për problemet teknologjike, me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit.

Programi orientues për provimin “Teknologji e thelluar”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2013-2014, përbën një dokument të vlefshëm për gjimnazin, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi orientues i teknologjisë së thelluar synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve në këtë lëndë.

- Të sigurojë informacionin e nevojshëm për mësuesit e teknologjisë së gjimnazit, që do të përgatisin maturantët për provimin e Teknologjisë së thelluar, si lëndë e rëndësishme në Maturën Shtetërore.
- Të pajisë nxënësit me materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë nxënësit për të përballuar me sukses provimin e “Teknologjisë së thelluar”, e cila përbën gjithashtu një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e tezës së provimit të Teknologjisë së thelluar.

Programi orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave:

- 1. Linjat dhe nënlinjat që përshkruajnë përmbajtjen e programit.**
- 2. Përshkrimi i linjave dhe nënlinjave me objektivat përkatës.**
- 3. Tabela e peshave sipas linjave.**

Ky program të shqyrtohet me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes të bëhet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të Teknologjisë së thelluar, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.

Vëmendje duhet të tregojnë këta specialistë dhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila linjë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto linja në testin e kontrollit për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e Teknologjisë së thelluar të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit duhet të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve teknologjike dhe aftësive të përcaktuara në program.

Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit janë njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që ata kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin e përmbajtjeve mësimore, të tilla si: tekste të ndryshme që kanë të bëjnë me teknologjinë, internetin etj.

2. TEMATIKA E PËRMBAJTJES SIPAS LINJAVE TË PROGRAMIT

I. Teknologjia bërthamë (klasa 12):

- 1. Teknologjia dhe sistemet teknologjike**
- 2. Komunikimi grafik**
- 3. Materialet teknologjike**
- 4. Strukturat dhe mekanizmat**
- 5. Teknologjia e prodhimit**
- 6. Teknologjia e shërbimeve**

II. Teknologjia me zgjedhje të detyruar (klasa 12):

1. **Komunikimi grafik**
2. **Teknologjia e transportit**
3. **Teknologjia e burimeve të energjisë**
4. **Teknologjia e elektricitetit**
5. **Teknologjia e mekanikës**
6. **Teknologjia e ndërtimit**
7. **Teknologjia ushqimore**
8. **Teknologjia e bujqësisë**

3. PËRSHKRIMI DHE PËRMBAJTJA E LINJAVE

I. TEKNOLOGJIA BERTHAME (klasa 12):

LINJA 1: TEKNOLOGJIA DHE SISTEMET TEKNOLOGJIKE

Linja “Teknologjia dhe sistemet teknologjike” u ofron nxënësve njohuritë kryesore për teknologjinë dhe sistemet teknologjike, për t’i bërë të aftë të analizojnë marrëdhëniet e tyre, si dhe të shoqërisë me teknologjinë dhe mjedisin dhe të përshkruajnë procedura teknologjike të bazuara në problem-zgjidhjen.

Nënlinja	Objektiva
Teknologjia, shoqëria, mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë kuptimin dhe qëllimin e teknologjisë; - të tregojë cilat janë llojet dhe etapat e progresit teknologjik; - të bëjë klasifikimin e drejtimeve kryesore teknologjike të sotme; - të përshkruajë ndikimin e teknologjisë në transformimet mjedisore, masat për mbrojtjen e këtij mjedisi dhe në zhvillimet e shoqërisë njerëzore; - të bëjë dallimin ndërmjet shkencës dhe teknologjisë; - të tregojë prirjet e zhvillimit të teknologjisë së të ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Sistemet teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë modelin e një sistemi teknologjik tipik dhe elementet kryesore të tij; - të tregojë grupet kryesore të inputeve (burimeve) të

	<p>sistemeve teknologjike;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë procese të ndryshme teknologjike; - të identifikojë outputet e sistemeve teknologjike; - të shpjegojë rolin dhe veprimin e mekanizmave të feedback-ut në sistemet teknologjike.
Nënlinja	Objektiva
Sistemet teknologjike dhe zgjidhja e problemit teknologjik	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë kuptimin e koncepteve “problem”, “problem teknologjik” dhe “zgjidhje e një problemi teknologjik”; - të tregojë se çfarë përmban projekti (plani) për zgjidhjen e një problemi teknologjik.

LINJA 2: KOMUNIKIMI GRAFIK

Linja “Komunikimi grafik” i njeh nxënësit me mënyrat kryesore të komunikimit grafik, të cilat përbëjnë gjuhën bazë të teknologjisë duke paraqitur, nëpërmjet skicimit, objekte të thjeshta teknike, mendimet dhe idetë e tyre, si dhe u jep mundësinë të lexojnë paraqitje grafike të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.

Nënlinja	Objektiva
Paraqitjet me prerje	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë kuptimin gjeometrik të paraqitjes me prerje; - të bëjë shënimin e prerjeve sipas standardit të vizatimit; - të bëjë vijëzimet e sipërfaqeve të prera; - të përdorë prerjet e thjeshta në paraqitjen e objekteve; - të përdorë bashkimet e pamjeve me prerjet në skicat dhe vizatime;
Nënlinja	Objektiva
Paraqitjet aksonometrike dhe hapjet e sipërfaqeve	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë kuptimin gjeometrik të paraqitjeve aksonometrike; - të ndërtojë me veglat e vizatimit dhe me dorë të lirë boshtet aksonometrikë për dimetrinë këndngushtë dhe izometrinë kënddrejtë;

	<ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë paraqitjet aksonometrike të figurave të rrafshëta (katrorit, drejtkëndëshit, trekëndëshit, gjashtëkëndëshit, rrethit); - të ndërtojë paraqitjet aksonometrike të trupave gjeometrikë kryesorë dhe të objekteve të thjeshta të dhëna në projeksionet kënddrejta ose në natyrë;
Nënlinja	Objektiva
Vizatimet e ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> - Të përcaktojë objektet e ndryshme në vizatimet e planeve të përgjithshme (genplanet); - të përcaktojë elementet konstruktive në vizatimet konstruktive të objekteve të ndërtimit; - Të përcaktojë elementet në planet (planimetritë) e objekteve të banimit;
Nënlinja	Objektiva
Vizatimet skematike	<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë simbolet e elementeve kryesore të vizatimeve skematike (skemave elektrike, kinematike dhe hidrosanitare); - të zbatojë skema të thjeshta elektrike, kinematike dhe hidrosanitare;

LINJA 3: MATERIALET TEKNOLOGJIKE

Linja “Materialet teknologjike” i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “material teknologjik”, me llojet dhe vetitë teknologjike të grupeve kryesore të materialeve teknologjike, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e materialeve teknologjike në teknologjinë e sotme.

Nënlinja	Objektiva
Teknologjia dhe materialet teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë konceptin e “materialeve teknologjike”; - të klasifikojë materialet teknologjike sipas grupeve kryesore; - të përshkruajë vetitë teknologjike kryesore të materialeve teknologjike.
Nënlinja	Objektiva

Vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë vetitë teknologjike të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme; - të japë shembuj të përdorimit të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme.
---	---

LINJA 4: STRUKTURAT DHE MEKANIZMAT

Linja “Strukturat dhe mekanizmat” i njeh nxënësit me kuptimin e koncepteve që lidhen me strukturat dhe mekanizmat teknologjikë, me klasifikimin dhe përdorimet e tyre, si dhe i aftëson ata të analizojnë ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjikë të sotëm.

Nënlinja	Objektiva
Strukturat dhe mekanizmat	<ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë strukturat dhe mekanizmat teknologjike; - të klasifikojë strukturat dhe mekanizmat teknologjike kryesore; - të tregojë veçoritë e strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore.
Nënlinja	Objektiva
Ndërtimi dhe funksionimi i strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë dhe të përshkruajë pjesët e veçanta (detalet) e strukturave dhe mekanizmave teknologjike.

LINJA 5: TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT

Linja “Teknologjia e prodhimit” i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji prodhimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të prodhimit në shoqërinë e sotme.

Nënlinja	Objektiva
Sistemet teknologjike të prodhimit	<ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë “teknologjinë e prodhimit”; - të klasifikojë dhe të përshkruajë llojet kryesore të teknologjive të prodhimit.

Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e prodhimit të energjisë	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë mënyrat dhe teknologjitë kryesore të prodhimit të energjive të llojeve të ndryshme; - të tregojë prirjet e teknologjisë së prodhimit të energjisë për shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e prodhimit industrial	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial; - të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit industrial për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Prodhimi artizanal	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të prodhimit artizanal; - të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit artizanal për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e prodhimit bujqësor	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor; - të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit bujqësor për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.

LINJA 6: TEKNOLOGJIA E SHËRBIMEVE

Linja “Teknologjia e shërbimeve” i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji shërbimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të shërbimit në shoqërinë e sotme.

Nënlinja	Objektiva
Sistemet teknologjike të shërbimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë “teknologjinë e shërbimit”; - të klasifikojë dhe të përshkruajë llojet kryesore të teknologjive të shërbimeve.

Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e shërbimeve të komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit; - të përshkruajë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit; - të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë shërbimeve të komunikimit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e shërbimeve të transportit (shpërndarjes)	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të transportit; - të përshkruajë llojet kryesore të teknologjisë së transportit; - të argumentojë rëndësinë e teknologjisë së transportit për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.
Nënlinja	Objektiva
Teknologjia e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit	<ul style="list-style-type: none"> - Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të mirëmbajtjes dhe riparimit; - të përshkruajë llojet kryesore të teknologjive të mirëmbajtjes dhe riparimit - të argumentojë rëndësinë e teknologjisë së mirëmbajtjes dhe riparimit për shoqërinë e sotme dhe të ardhmes.

II. TEKNOLOGJIA ME ZGJEDHJE TE DETYRUAR (klasa 12)

LINJA 1: KOMUNIKIMI GRAFIK (Hapjet dhe ndërprerjet e sipërfaqeve)

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë jepen njohuri të mjaftueshme për zgjidhjen e problemeve praktike dhe përgatitjen e shablloneve të prodhimit të artikujve të ndryshëm, që përgatiten prej materialesh në formë fletësh.

Linja	Objektiva
Hapjet dhe ndërprerjet e sipërfaqeve	<ul style="list-style-type: none">- Të hapë sipërfaqen e bërnylit cilindrik trepjesësh të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tij;- të hapë sipërfaqen e piramidës të drejtë me bazë drejtkëndëshe të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së saj;- të hapë sipërfaqen e piramidës të drejtë me bazë katrore të prerë pjerrtas të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së saj;- të hapë sipërfaqen e konit të drejtë të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tij;- të hapë sipërfaqen e konit të drejtë të prerë pjerrtas të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tij;- të bëjë hapjen e sipërfaqes së konit të pjerrët të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tij;- të bëjë hapjen e elementit bashkues të tubit me seksion drejtkëndësh me tubin rrethor të dhënë në projeksione dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tij;- të ndërtojë vijën e ndërprerë të dy prizmave me bazë drejtkëndëshe të dhënë në projeksione, të hapë sipërfaqet e tyre dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes së tyre;- të ndërtojë vijën e ndërprerjes të prizmit me bazë

	<p>katrore të ndërfutur te koni të dhënë në projeksione;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë vijën e ndërprerjes së sipërfaqeve të cilindrit të ndërfutur te koni të dhënë në projeksione, të realizojë hapjen e sipërfaqeve të tyre dhe të përgatisë shabllonin e sipërfaqes.
--	--

LINJA 2: TEKNOLOGJIA E TRANSPORTIT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan veçoritë e teknologjisë së transportit, sistemet kryesore të tij, mjetet lëvizëse që përdoren në lloje të ndryshme transporti, si dhe sistemet kryesore nga të cilat ndërtohen këto mjete.

Linja	Objektiva
Teknologjia e transportit	<ul style="list-style-type: none"> - Të rendisë elementet përbërëse të sistemit të transportit e të japë shembuj për to; - të rendisë nënsistemet e transportit e të tregojë funksionet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e mjeteve të transportit tokësor, rrugor dhe hekurudhor; - të përshkruajë veçoritë e mjeteve të ndryshme të transportit ujor; - të përshkruajë veçoritë e mjeteve të ndryshme të transportit ajror; - të tregojë pjesët kryesore të motorëve me djegie të brendshme; - të tregojë si realizohen proceset e një cikli që zhvillohet në motorët me djegie të brendshme; - të japë shembuj të lëvizjes së mjeteve me energji të erës, diellore, elektrike dhe bërthamore; - të përshkruajë sistemet e transmisionit, komandimit dhe drejtimit të mjeteve të transportit; - të përshkruajë sistemet e varjes së mjeteve të transportit; - të përshkruajë sistemet strukturore të mjeteve të

	transportit.
--	--------------

LINJA 3: TEKNOLOGJIA E BURIMEVE TË ENERGISË

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin dhe veçoritë e teknologjisë së burimeve të energjisë, sistemet kryesore të kësaj teknologjie, rëndësinë dhe përdorimet e tyre në ekonomi dhe në jetën e përditshme.

Linja	Objektiva
Teknologjia e burimeve të energjisë	<ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë cilat janë format dhe llojet kryesore të energjisë, si dhe burimet e tyre fillestare; - të rendisë elementet përbërëse të një sistemi teknologjik tipik për burimet e energjisë; - të tregojë parimet e funksionimit dhe veçoritë ndërtimore të sistemeve teknologjike kryesore që bëjnë shfrytëzimin e energjisë së erës, të Diellit, të ujërave e të lëndëve të djegshme, të energjisë bërthamore etj.; - të tregojë cilat janë burimet e energjisë që do të kenë përparësi në të ardhmen dhe të shpjegojë arsyet.

LINJA 4: TEKNOLOGJIA E ELEKTRICITETIT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin dhe veçoritë e teknologjisë së elektricitetit, sistemet kryesore për prodhimin, transformimin, transportimin, shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë elektrike dhe tregon rëndësinë dhe përdorimet e kësaj teknologjie në ekonomi dhe në jetën e përditshme.

Linja	Objektiva
Teknologjia e elektricitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë sistemet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike (centralet elektrike, burimet kimike) dhe veçoritë e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri; - të përshkruajë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve elektroshtëpiake kryesore; - të përshkruajë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e elementeve kryesore të instalimit

	<p>elektrik të banesës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë rreziqet që vijnë nga rryma elektrike dhe të shpjegojë masat mbrojtëse.
--	--

LINJA 5: TEKNOLOGJIA E MEKANIKËS

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin e teknologjisë së mekanikës dhe rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe analizon veçoritë konstruktive e funksionale të sistemeve e makinave të mekanikës, që janë më të përdorshme në përpunimin mekanik, në ekonomi dhe në jetën e përditshme.

Linja	Objektiva
Teknologjia e mekanikës	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë elementet e sistemit teknologjik mekanik dhe pjesët përbërëse të tyre (sistemin motor, sistemin transmetues dhe sistemin zbatues); - të përshkruajë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e transmisioneve mekanike kryesore dhe tregojë zbatimet e tyre;

LINJA 6: TEKNOLOGJIA E NDERTIMIT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin e teknologjisë së ndërtimit dhe rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe analizon veçoritë konstruktive e funksionale të sistemeve teknologjike të ndërtimit. Gjithashtu, përshkruan arkitekturën, konstruksionet e rrjetave inxhinierike, makinat e ndërtimit, urbanistikën dhe zhvillimin e banesës.

Linja	Objektiva
Teknologjia e ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë llojet, veçoritë dhe elementet e ndërtesave, çfarë kushtesh duhet të plotësojnë dhe si klasifikohen ato; - të përshkruajë strukturat, elementet konstruktive, plotësuese, funksionale dhe estetike të ndërtesave; - të lexojë planimetri, pamje dhe prerje ndërtesash të thjeshta, si dhe projekte të thjeshta arkitektonike; - të përshkruajë veçoritë dhe përdorimet e materialeve

	<p>të ndërtimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë cilat janë rrjetat e instalimeve kryesore shtëpiake dhe të përshkruajë si funksionojnë; - të përshkruajë urbanistikën dhe për elementet strukturore të qendrave të banimit; - të paraqesë prirjet e zhvillimit të teknologjisë së ndërtimit në të ardhmen dhe ndikimin që do të ketë për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.
--	--

LINJA 7: TEKNOLOGJIA USHQIMORE

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin e teknologjisë ushqimore dhe rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe analizon veçoritë konstruktive e funksionale të sistemeve të teknologjisë ushqimore që kanë të bëjnë me proceset e prodhimit, konservimit, ambalazhimit etj.

Linja	Objektiva
Teknologjia ushqimore	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë inputet dhe produktet kryesore të teknologjisë ushqimore; - të përshkruajë metodat dhe proceset kryesore të parapërgatitjes së inputeve, si dhe të përpunimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve ushqimore; - të rendisë masat teknologjike që merren për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore.

LINJA 8: TEKNOLOGJIA E BUJQESISE

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë përshkruan kuptimin e teknologjisë së bujqësisë dhe rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe analizon veçoritë konstruktive e funksionale të sistemeve të teknologjisë bujqësore që kanë të bëjnë me proceset e prodhimit të produkteve bujqësore etj.

Linja	Objektiva
--------------	------------------

Teknologjia e bujqësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë drejtimet kryesore të bujqësisë, si dhe nënsistemet teknologjike përkatëse; - të përshkruajë metodat dhe proceset kryesore të bujqësisë (punimi i tokës, plehërimi, ujitja, kullimi, mbjellja, kultivimi, mbledhja e prodhimit, transportimi etj.); - të përshkruajë metodat dhe proceset kryesore të blegtorisë (të ushqyerit, riprodhimi, shërbimet e tjera të kafshëve dhe shpendëve bujqësore).
--------------------------------	--

4. TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE TË LINJAVE NË PËRQINDJE

I. TEKNOLOGJIA BERTHAME (klasa 12):

Linjat	Përqindja
Teknologjia dhe sistemet teknologjike	10 %
Komunikimi grafik	19 %
Materialet teknologjike	4 %
Strukturat dhe mekanizmat	9%
Teknologjia e prodhimit	4%
Teknologjia e shërbimeve	4%
Gjithsej:	50%

II. TEKNOLOGJIA ME ZGJEDHJE TE DETYRUAR (klasa 12):

Linjat	Përqindja
Komunikimi grafik	13%
Teknologjia e transportit	7%
Teknologjia e burimeve të energjisë	6%
Teknologjia e elektricitetit	6%
Teknologjia e mekanikës	6%
Teknologjia e ndërtimit	4%
Teknologjia ushqimore	4%
Teknologjia e bujqësisë	4%
Gjithsej:	50%

III. TEKNOLOGJI E THELLUAR:

**Teknologji bërthamë + Teknologji me zgjedhje të detyruar = 50% + 50% =
100%**